



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Në bazë të nenit 48 paragrafi 1 pika 7 të Ligjit për Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/2010), neni 5 paragrafi 6 i Ligjit për mbrojtjen e konsumatorëve gjatë marrëveshjeve për kredi konsumatore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 51/2011) dhe pika 16 paragrafi 2 i Vendimit për metodologjinë për llogaritjen e normës vjetore të kostove totale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 91/ 2011), Guvernatori i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë miratoi

UDHËZIM

për formën dhe përmbajtjen e formularit me informacion parakontraktor për kushtet e ofruara të kredisë për kredi konsumatore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 101/2011)

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Me këtë udhëzim përcaktohen forma dhe përmbajtja e formularit me informacion parakontraktor për kushtet e ofruara të kredisë për kredi konsumatore.
2. Kreditori, gjegjësisht ndërmjetësi i kredisë, është i detyruar konsumatorit t'ia tregojë të gjitha informacionet dhe të dhënat e nevojshme për lidhjen e marrëveshjes së kredisë konsumatore, para se të lidhë marrëveshje, përmes dorëzimit të formularit për informacion parakontraktor për kushtet e ofruara të kredisë për kredi konsumatore (në tekstin e mëtejme: formulari).
3. Formulari përbëhet nga katër grupe informacioni dhe të dhënash dhe dy kolona.

Kreditori, gjegjësisht ndërmjetësi i kreditit nuk guxon:

- të ndryshojë rendin e reshtave në formularin,
- lënie të rreshtave dhe fushave bosh (nëse kreditori gjegjësisht ndërmjetësi i kredisë nuk ka informacion përkatës, shënon për atë fushë se nuk ka informacione)
- të ndryshojë përmbajtjen në kolonën numër 1 të formularit.

Sqarimet në kolonën numër 2 të formularit të dhënë në kllapa, duhet të zëvendësohen me informacionin dhe të dhënat e duhura nga kreditori, gjegjësisht ndërmjetësuesi i kredisë..

4. Kreditori, gjegjësisht ndërmjetësuesi i kredisë, është i detyruar të sigurojë dëshmi se konsumatori ka marrë formularin.
5. Formulari është dhënë në shtesën nr. 1, që është pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

II. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

6. Ky udhëzim hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e publikimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", dhe do të fillojë të zbatohet nga 01.10.2011.

U nr. 6460
20.07.2011
Shkup

Guvernator
Димитар Богов

FORMULARI
PËR INFORMACION (TË DHËNA) PARAKONTRAKTUESE PËR KUSHTET E OFRUARA TË
KREDISË PËR KREDI KONSUMATORE

1. Të dhëna për kreditorin/ndërmjetësuesi i kredisë

TË DHËNA PËR KREDITORIN	
Kolona 1	Kolona 2
Emri i kreditorit	
Adresa (adresa adresën në të cilën kreditori është në dispozicion)	
Numri i telefonit*	
Posta elektronike*	
Faksi*	
Ueb faqja*	
TË DHËNA PËR NDËRMJETËSIN E KREDISË (nëse është e aplikueshme)	
Emri dhe mbiemri, gjegjësisht emri i ndërmjetësit të kredisë	
Adresa (adresa në të cilën është në dispozicion ndërmjetësi i kredisë)	
Numri i telefonit*	
Posta elektronike*	
Faksi*	
Ueb faqja*	

* Këto informacione nuk janë të detyrueshme për kreditorin / ndërmjetësin e kredisë

2. Të dhëna për produktin e kredisë

Kolona 1	Kolona 2
Lloji i kredisë	<i>(Përshkrimi i llojit të kredisë)</i>
Shuma totale e kredisë që përfshin:	<i>(Shuma duhet të shprehet si shumë e parave, Për shembull:</i>
– valuta në të cilën është shprehur kryegjëja ose me të cilën është lidhur kryegjëja,	<i>denarë/euro/dollarë/ në denarë lidhur me vlerën e euros ose me valutë tjetër</i>

– shuma totale në denarë, për kreditë e miratuara në denarë – shuma totale në valutë të huaj, për kreditë e miratuara në valutë të huaj shuma totale në denarë si kundërvlerë në valutë të huaj, për kreditë me klauzolë valutore – kursi i këmbimit pas së cilës kryhet pagesa e kredisë (nëse është e aplikueshme) – kursi i këmbimit me të cilin do të kryhet pagesa e kredisë (nëse është e aplikueshme). Shënohet lartësia e kursit të këmbimit në ditën e përgatitjes së formularit. Gjatë shlyerjes së anuitetit të kredisë (me këste), lartësia e kursit të këmbimit për këstet individuale mund të dallohet.	<i>shuma në denarë - për marrëveshjet specifike kreditore është shënuar kufiri i sipërm i kredisë në dispozicion</i> <i>shuma në valutë të huaj</i> <i>shuma në denarë dhe shuma në valutë të huaj</i> _____ (lloji i kursit) i cili në ditën e përgatitjes së formularit arrin në: _ _____ (lloji i kursit) i cili në ditën e përgatitjes së formularit arrin në: _____)
Kushtet për përdorimin e kredisë (si dhe kur do të kryhet pagesa e mjeteve në bazë të kredisë)	<i>(Përshkrimi si dhe kur do të tërhiqet kredia ose këstet e kredisë)</i>
Kohëzgjatja e marrëveshjes së kredisë konsumatore	<i>(Afati i vlefshmërisë së marrëveshjes për kredi ose deklarimi se marrëveshja nuk ka afat skadence)</i>
Shuma e kësti të vetëm, numri i kësteve dhe nëse është e aplikueshme radha e mbërritjes së kësteve që duhen paguar	<i>(Duhet të paguani:</i> <i>Bashkangjitni shembull reflektues të planit amortizues, i cili përfshin shumën, numrin dhe radhën e pagesave që konsumatori është i obliguar t'i kryejë, veçmas për kryegjënë, interesat dhe provizionet)</i>
Përshkrimi i mallit ose shërbimit dhe çmimi i tij në para të gatshme, në rastin e kredisë në formën e pagesës së shtyrë për mallra ose shërbime të caktuara dhe marrëveshje kredie të lidhura (nëse është e aplikueshme)	<i>(Përshkrimi i mallit/ shërbimit)</i> <i>(Çmimi në para të gatshme)</i>

Garancitë e kredisë (përshkrimi i instrumentit të sigurisë që kërkohet nga aplikuesi i kredisë për të lidhur marrëveshje për kredi konsumatore)	<i>(Përshkrimi i instrumentit të sigurimit që kërkohet nga kreditori dhe kushtet që ai të pranohet si sigurim)</i> <i>(Nëse nuk kërkohet asnjë sigurim, shënohet se kredia nuk ka sigurim)</i>
Lloji i sigurimit sipas marrëveshjes për sigurim	<i>(Lloji, përshkrimi dhe kushtet e kërkuara që sigurimi të pranohet nga kreditori)</i> <i>(Nëse nuk kërkohet sigurim, shënohet se sigurim për kredinë nuk kërkohet)</i>
Detyrimi për lidhjen e marrëveshjes për shërbime shtesë, me përjashtim të marrëveshjes së sigurimit, nëse lidhja e një marrëveshje të tillë është e detyrueshme për marrjen e kredisë ose për marrjen e kredisë në pajtim me kushtet e shpalljes	<i>(Lloji dhe përshkrimi i shërbimeve shtesë që kërkohen nga kreditori për miratimin e kredisë)</i>
Llogari e veçantë në të cilën janë regjistruar arkëtimet dhe pagesat në bazë të detyrimeve të kredisë	<i>(Shënohet nëse është e detyrueshme të hapet llogari e veçantë në të cilën regjistrohen arkëtimet dhe pagesat në bazë të detyrimeve sipas kredisë)</i>

2. Të dhëna për kostot e kredisë

Kolona 1	Kolona 2
Lloji i normës së interesit	<i>(Shënohet lloji i normës së interesit dhe atë:</i> <i>– për normë interesi fikse jepet shpjegimi se norma e interesit është e pandryshueshme</i> <i>– për normë interesi të ndryshueshme shënohet indeksi ose norma e interesit referencë mbi të cilën bazohet lartësia e</i>

Kreditori është i detyruar të informojë konsumatorin për llojin e normës së interesit dhe t'i japë shpjegim se çfarë nënkupton ajo normë interesi, si dhe periudhat, kushtet dhe kushtet dhe procedurat për ndryshimin e normës së interesit Kreditori është i detyruar të informojë konsumatorin nëse për ndryshimin e normës së interesit është e nevojshme pëlqimi paraprak nga konsumatori Nëse në periudha të ndryshme aplikohen interese të ndryshme, të gjitha informacionet e shënuara shënohen për secilën normë interesi	<i>norma e interesit, periudhat, kushtet dhe procedura për ndryshimin e normës së ndryshueshme të interesit si dhe marzhi i arkëtuar nga kreditori dhe periudhat, kushtet dhe procedura për ndryshimin e saj</i> <i>– për normë interesi të rregullueshme, jepet shpjegim se çfarë nënkuptohet me normë interesi të rregullueshme, periudha, kushtet dhe procedura për ndryshimin e normës së interesit të rregullueshme)</i> A është i nevojshëm pëlqimi paraprak për ndryshimin e normës së interesit të cilin e arkëton kreditori PO/JO
Lartësia e normës së interesit në bazë vjetore në ditën e dhënies së formularit Nëse në periudha të ndryshme aplikohen norma të ndryshme interesi , të gjitha informacionet shënohen për secilën normë interesi	<i>(Përqindja e normës së interesit të dakorduar në bazë vjetore në ditën e dhënies së formularit)</i> <i>(Nëse përdoret normë interesi e ndryshueshme, duhet të shtohet indeksi i pavarur ose norma e interesit referencë dhe marzhi të cilën e arkëton kreditori.)</i>
Norma vjetore e kostove totale (SVT) dhe shuma totale të cilën e paguan konsumatori (shuma totale e kredisë, duke përfshirë interesin dhe kostot e tjera për kredinë të paraqitura përmes shembullit përfaqësues në të cilin janë shënuar të gjitha supozimet për llogaritjen e normës vjetore të kostove totale.)	<i>(Lartësia e SVT dhe shuma totale të cilën e paguan konsumatori)</i> <i>(Të jepet shembull përfaqësues me të gjitha supozimet për llogaritjen e SVT)</i>

Kostot për lidhjen e marrëveshjes për shërbime shtesë në lidhje me marrëveshjen për kredi konsumatore, si për shembull marrëveshje sigurimi, nëse lidhja e një marrëveshje të tillë është e detyrueshme për marrjen e kredisë ose për marrjen e kredisë në pajtim me kushtet e shpalljes (nëse është e aplikueshme) Kreditori mund të shënojë shumën e përafërt të kostove, nëse nuk disponon shumën e saktë të tyre	<i>(Shuma e kostove të sigurimit ose detyrimi tjetër dytësor/ shërbimi që është i detyrueshëm për miratimin e kredisë)</i> <i>(Nëse nuk dihet shuma e saktë e kostove, thuhet se bëhet fjalë për shumë të përafërt)</i>
Kostot e mbajtjes së një ose më shumë llogarive në të cilat regjistrohen arkëtimet dhe pagesat e pjesës së përdorur të kredisë (nëse është e aplikueshme) Kreditori mund të shënojë shumën e përafërt të kostove, nëse nuk disponon me shumën e saktë të tyre	<i>(Shuma e kostos për mbajtjen e llogarisë)</i> <i>(Nëse shuma e saktë e kostove nuk dihet, shënohet se bëhet fjalë për shumë të përafërt)</i>
Kostot noteriale që i paguan konsumatori me rastin e lidhjes së marrëveshjes (nëse është e aplikueshme) Kreditori mund të shënojë shumën e përafërt të kostove, nëse nuk disponon me shumën e saktë të tyre	<i>(Përshkrimi dhe shuma e kostove noteriale)</i> <i>(Nëse shuma e saktë e kostove nuk dihet, thuhet se bëhet fjalë për shumë të përafërt)</i>
Kostot e tjera që rrjedhin nga marrëveshja e kredisë konsumatore dhe kushtet në të cilat këto kosto mund të ndryshohen (nëse është e aplikueshme) Kreditori mund të shënojë shumën e përafërt të kostove, nëse ato nuk disponon me shumën e saktë të tyre	<i>(Përshkrimi dhe shuma e kostove dhe kushteve të tjera në të cilat ato mund të ndryshohen)</i> <i>(Nëse shuma e saktë e kostove nuk dihet, thuhet se bëhet fjalë për shumë të përafërt)</i>
Norma e interesit e aplikueshme në rast të pagesave me vonesë në bazë vjetore, kushtet për ndryshimin e saj Paralajmërim për pasojat e mospagesës së kësteve	<i>(Shembull:</i> <i>Për lëshimin e afatit për pagesë / pagesa e vonuar do të arkëtohet: _____</i> <i>Interesi ndëshkues gjatë</i>

	<i>lidhjes së marrëveshjes për kredi konsumatore, kushtet për ndryshimin e tij dhe, nëse është e aplikueshme kostot e mospërbushjes së detyrimit të pagesës</i> <i>Specifikimi i pasojave të mospagesës së kësteve e cilat mund të përfshijë:</i> – baza ligjore e procedurës për ekzekutimin e kërkesave – paralajmërim se lëshimi i kësteve mund të rezultojë në miratimin e vështirë të kredisë)
--	--

3. Tjetër

Kolona 1	Kolona 2
E drejta për të anuluar marrëveshjen e kredisë konsumatore (Keni të drejtë të anuloni marrëveshjen për kredi konsumatore në afat prej 14 ditëve, nga dita e lidhjes së marrëveshjes ose dita kur keni marrë informacionet dhe kushtet e marrëveshjes)	<i>(Duke specifikuar të drejtën e konsumatorit për anulimin e marrëveshjes për kredi konsumatore dhe periudhën kohore në të cilën mund të anulohet marrëveshjen)</i>
Kompensimi i kreditorit në rast të shlyerjes së parakohshme dhe mënyra e përcaktimit të tij (Keni të drejtën e shlyerjes së plotë ose të pjesshme të parakohshme të kredisë dhe kreditori është i detyruar t'ju informojë për shumën kompensimin të përcaktuar në pajtim me nenin 16 të Ligjit për mbrojtjen e konsumatorëve gjatë marrëveshjeve për kredi konsumatore)	<i>(Shënohet shuma ose përqindja e kompensimit dhe mënyra e përcaktimit të tij)</i>
Shkëputja e marrëveshjes për kredi konsumatore (Kreditori është i detyruar t'ju informojë për të drejtën, procedurën dhe kushtet për shkëputjen e marrëveshjes për kredi konsumatore)	<i>(Shënohen e drejta, procedura dhe kushtet për shkëputjen e marrëveshjes për kredi konsumatore)</i>

Informacion nga inspektimi i kryer në bazë të dhënash me qëllim të vlerësimit të aftësisë kreditore të konsumatorit (Nëse kërkesa për kredi refuzohet për shkak të informacioneve të marra nga baza e të dhënave, kreditori është i detyruar të informojë menjëherë dhe pa pagesë konsumatorin për atë informacion dhe për mënyrën se si i ka furnizuar informacionet. Këto informacione jepen në të gjitha rastet, përveç nëse dhënia e informacioneve është e ndaluar me ligj)	<i>(Informimi në kohë dhe pa pagesë për konsumatorin për informacionin e marrë nga inspektimi i bazës së të dhënave, si dhe për mënyrën se si ato janë furnizuar)</i>
E drejta e shembullit pa pagesë të propozim - marrëveshjes për kredi konsumatore (Keni të drejtë, me kërkesën tuaj, pa pagesë të merrni shembull të kopjes të propozim - marrëveshjes për kredi konsumatore. Nuk do të dorëzohet propozim - marrëveshje nëse kreditori gjatë parashtrimit të kërkesës nuk dëshiron të lidhë një marrëveshje për kredi konsumatore .)	<i>(Dorëzimi i shembullit të propozim - marrëveshjes për kredi konsumatore, nëse është e aplikueshme)</i>
Afati në të cilin kreditori është i lidhur me informacionet parakontraktor	Informacionet Информациите të përfshira në këtë formular vlejné prej _____deri _____.

Vendi, data

Dorëzoi:

Pranoi:
